



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura IV**

Kryesia e Kuvendit

P-148

Prishtinë, më 10 mars 2014, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 10 MARS 2014**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Myfera Shinik.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

**Nga Zyra e Presidentit:** Amir Haradinaj dhe

**Nga OSBE-ja:** Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 mars 2014,
2. Vazhdimi i seancës plenare të filluar më 27 shkurt 2014,
3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
4. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave,
5. Të ndryshme.

### **1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 mars 2014**

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 mars 2014.

### **2. Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 27 shkurt 2014**

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikat e papërfunduara të seancës së mëparshme, vendosi që ajo t'i vazhdojë punimet të enjten, më 13 mars 2014, në orën 10:00, me këtë:

### **Rend dite**

1. *Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me gjendjen e sigurisë në shkollat e Republikës së Kosovë,*
2. *Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me gjendjen e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë,*
3. *Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të IGK "Ballkani", në Suharekë.*

### **3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës**

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më 13 mars 2014, në orën 10:00, me këtë:

## **Rend dite**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe provimin e Maturës Shtetërore,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
8. Shqyrtimi i Planit Hapësinor “Monumenti i natyrës me rëndësi të veçantë - Ujëvarat e Mirushës”,
9. Shqyrtimi i Planit Hapësinor “Zona e mbrojtur me interes të veçantë - Beteja e Koshares”,
10. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për hartimin e Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”,
11. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare,
12. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit,
13. Zgjedhja e Avokatit të Popullit,
14. Zgjedhja e një anëtari joekzekutiv në Bordin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
15. Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, dhe
16. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media.

\* \* \*

Kryesia, pas diskutimit lidhur me pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës së seancës plenare - Rekomandimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nxori këtë:

## **P ë r f u n d i m**

Kërkohej nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision Funkcional që ta rishqyrtojë propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

#### **4. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave**

##### *1. Procedimi i Projektligjit për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme*

Kryesia, pas diskutimit lidhur me projektligjin e lartpërmendur, nxori këtë:

#### **P ë r f u n d i m**

1. Projektligji për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme, i propozuar nga deputetja Albulena Haxhiu, e përkrahur nga grupi i deputetëve nënshkrues, t'u shpërndahet të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Legjislacion, si Komision Funksional, që ta shqyrtojë projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

##### *2. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie*

Propozimin e lartpërmendur Kryesia e radhiti në rend të ditës për mbledhjen plenare të radhës dhe nxori këtë:

#### **P ë r f u n d i m**

1. Kërkohej nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në seancën e radhës, më 13 mars 2014, t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie.

2. Përbërja e Komisionit duhet të jetë, si në vijim: GP i PDK-së, 2 anëtarë; GP i LDK-së, 2 anëtarë; GP VV, 1 anëtar; GP i AAK-së, 1 anëtar; GP i KKR-së, 1 anëtar; GP i SLS-së, 1 anëtar dhe GP "6+", 1 anëtar.

##### *3. Shqyrtimi dhe miratimi i deklaratës për partneritet ndërmjet Kuvendit dhe Shoqërisë Civile*

Pikën e lartpërmendur, Kryesia e shtyu për shqyrtim për mbledhjen e vet të radhës.

##### *4. Kërkesë për mbulimin e shpenzimeve me rastin e vizitës në Kosovë të delegacionit nga Komisioni për Punë të Jashtme i Kuvendit të Shqipërisë*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartpërmendur, mori këtë:

## **V e n d i m**

1. Miratohet kërkesa e Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Kosovës për mbulimin e shpenzimeve me rastin e vizitës të Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në Kosovë gjatë muajit prill 2014.

2. Të gjitha shpenzimet e dala me rastin e pritjes së delegacionit të Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë akomodimin dhe drekat/darkat zyrtare, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

### *5. Kërkesë për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartpërmendur, mori këtë:

## **V e n d i m**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Punë të Jashtme: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Berat Buzhala, Sabri Hamiti, Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Emilija Rexhepi, Hamza Balje, si dhe nga stafi mbështetës i Komisionit, Manush Krasniqi, në Bruksel, prej 6-9 prill 2014.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

### *6. Kërkesë për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartpërmendur, mori këtë:

## **V e n d i m**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit, Ahmet Isufi dhe Arsim Bajrami, si dhe nga Administrata e Kuvendit, Visar Krasniqi, për të marrë pjesë në takimin e Komisionit të Përbashkët me temë: “Prioritetet e ardhshme në fushën e lirisë së qytetarëve, drejtësisë dhe çështjeve të brendshme”, që do të mbahet në Bruksel, prej 18-20 mars 2014.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

### *7. Vendimi i Qeverisë së Kosovës për kursimin e 15 % të shpenzimeve në kategorinë ‘mallra, shërbime dhe komunali’, të organizatave buxhetore për vitin 2014*

Për pikën e lartpërmendur të rendit të ditës diskutuan: Jakup Krasniqi, Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini dhe Myzejene Selmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesia, pas diskutimit lidhur me vendimin e lartpërmendur, nxori këtë:

## **P ë r f u n d i m**

Buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2014 nuk u nënshtrohet shkurtimeve buxhetore prej 15 % të shpenzimeve në kategorinë ‘mallra, shërbime dhe komunalit’, sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 07/172, datë 27.2.2014.

*8. Njoftimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri, prej 23-25 shkurt 2014*

Kryesia u njoftua me vizitën zyrtare të realizuar nga Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike në Shqipëri, prej 23-25 shkurt 2014.

*9. Njoftimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Bruksel, prej 18-21 shkurt 2014*

Kryesia u njoftua me vizitën zyrtare të realizuar nga Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në Bruksel, prej 18-21 shkurt 2014.

### **Pikat shtesë:**

*1. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2013*

Raportin e lartpërmendur, Kryesia e shtyu për shqyrtim për mbledhjen e radhës së Kryesisë.

### **Të ndryshme**

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se Qeveria e Republikës së Kosovës i ka dërguar në Kuvend amendamentet për Forcën e Sigurisë së Republikës së Kosovës, të cilat do t'i dërgohen Gjykatës Kushtetuese nga Kuvendi për të vlerësuar paraprakisht nëse amendamentet e propozuara i zvogëlojnë të drejtat dhe liritë e garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Jakup KRASNIQI**

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*